



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr.329/2Prot.

Tiranë, më 17. 02.2025

V E N D I M

Nr. 37, Datë 17 . 02 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 199, datë 23.09.2024, e znj. S. G. kundër Bashkisë Kavajë, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Unë jam S. G., nga Kavaja. Kam mbaruar arsimin profesional dyvjeçar për edukatore 0-3 vjeç në vitin 2019-2021. Në qershor 2022 u punësova nga Zyra e Punës Kavajë në çerdhen “Nektari i Jetës” (me gjysmë page) në bazë të ligjit për nxitjen e punësimit për personat me PAK. Edhe pse Bashkia Kavajë kishte të drejtë të rinovonte kontratën njëvjeçare në përputhje me ligjin (të praktikave profesionale), më hoqi pa një njoftim në nëntor 2022. Që nga ajo ditë e deri në këtë moment jam e papunë. Letrat i kam dorëzuar në bashki, por pa asnjë rezultat. Përveç shumës 7500 lekë të reja, nuk kam asnjë të ardhur tjetër që të plotësoj nevojat e mia personale dhe shëndetësore. Shpresoj të më kuptoni, sepse të gjithë jemi qytetarë të këtij vendi dhe e meritojmë të drejtohemi njëjtë, pa dallim aftësisish për punë.”

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe çfarë i takon nga ligji.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1297/2 prot., datë 02.10.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Kavajë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit, si më poshtë:

Nga ana e Bashkisë Kavajë:

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

- Informacion në lidhje me pretendimet e bëra nga ana e ankueses.
- Informacion lidhur me qëndrimin e Bashkisë Kavajë mbi kërkesën për punësim të bërë nga ankuesja, si dhe shkaqet pse nuk i është rilidhur kontrata në një pozicion të përshtatshëm sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 17, datë 15.01.2020, të ndryshuar.
- Informacion nëse nga ana e Bashkisë Kavajë janë rilidhur kontratat e punës për punëkërkesit A. Belba, M. Bushi, S. Demrozi, të cilët kanë qenë të punësuar pranë Bashkisë Kavajë sipas Marrëveshjes nr. 2734/4 prot., datë 27.05.2022 të AKPA.
- Informacion nëse pozicioni i punës edukatore, që ka ushtruar ankuesja, është zëvendësuar; nëse po, duhet na vihet në dispozicion dokumentacioni i emërimit të saj dhe dosja e plotë e dokumentacionit të zëvendësuese.
- Informacion nëse nga ana e Bashkisë Kavajë janë lidhur kontrata të tjera pune për persona me aftësi të kufizuara, në kuadër të zbatimit të qëllimeve të programit të punësimit, siç parashikohet në VKM-në nr. 17, datë 15.01.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit përmes punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale,” të ndryshuar.
- Si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për sqarimin e situatës të pretenduar nga ankuesja.

Nga ana e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive:

- Informacion mbi masat e ndërmarra nga ana e AKBN-së për verifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të parashtruara nga ankuesja, si dhe parashtrimet tuaja dhe aktet shkresore provuese, nëse ka.
- Informacion mbi masat e ndërmarra në kuadër të zbatimit të qëllimeve të programit të punësimit, siç parashikohet në VKM-në nr. 17, datë 15.01.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit përmes punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale,” të ndryshuar.
- Gjithashtu, çdo informacion tjetër që ju do ta vlerësonit të nevojshëm për sqarimin e situatës së pretenduar nga ankuesja.
- Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër të arsyeshëm që do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- Me shkresën nr.5048/1 prot., datë 11.10.2024², Bashkia Kavajë dërgoi një informacion në lidhje me këtë çështje, duke informuar se: *Znj. S., nuk ka qenë asnjëherë e punësuar nga ana e Bashkisë Kavajë në cilësinë e punëdhënësit, por ajo ka qenë praktikante pranë Çerdhes së Qytetit, në bazë të një marrëveshjeje trepalëshe që ka patur ndërmjet Bashkisë Kavajë për një periudhë gjashtëmujore. Trajtimi financiar është bërë nga fondet e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në përputhje me Marrëveshjen e cila është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020.*

² Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1297/3 prot, datë 14.10.2024

Sistemimi i ankueses në pozicionin "Kujdestare Çerdhje" pranë institucionit të Bashkisë Kavajë, nuk ka qenë e mundur, për arsye se nuk ka pasur dhe nuk ka vazhduar të ketë vende të lira pune. Ankueses i është bërë e qartë se në momentin e parë që do të hapet një pozicion vakant, ajo do të ketë përparësi para konkurentëve të tjerë. Me shtetasit A. Belba, M. Bushi dhe S. Demrozi nuk ka rilidhje kontrate, pasi ata kanë pasur një marrëveshje gjashtëmuajore. Ankuesja nuk është zëvendësuar pasi ajo nuk ka pasur një pozicion të mirëfilltë pune, përkatësisht vendet e punës në Çerdhen e Qytetit kanë qenë të plotësuara edhe gjatë kohës që ankuesja ka kryer praktikën profesionale.

Për sa i përket lidhjes së kontratës së punës me personat me aftësi të kufizuara, ata janë punësuar në pozicione që përshtaten me arsimin e tyre. Përsa i përket pozicionit "Kujdestare Çerdhje", nuk janë hapur pozicione të reja pune dhe për rrjedhojë nuk janë lidhur kontrata. Për sa më lart, del qartë se nga ana e Bashkisë Kavajë nuk ka pasur asnjë lloj diskriminimi ndaj Znj. S.

Bashkëlidhur kësaj shkrese, ju paraqesim Marrëveshjen Nr. 2734/4 Prot, datë 27.05.2021, të njësuar me origjinalen.

- Me shkresën nr.2441/3 prot., datë 27.09.2024³, Agjencia Kombëtare e Punësimit dërgoi informacion në lidhje me këtë çështje, duke informuar se: Znj. S., G. ka qenë e regjistruar si punëkërkuese e papunë në Zyrën Vendore të Punësimit Kavajë, në Drejtorinë Rajonale të AKPA Tiranë. Në zbatim të misionit të saj, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) zbaton programe të nxitjes së punësimit, që synojnë fuqizimin e kapaciteteve personale dhe profesionale të punëkërkuësve të papunë dhe integrimin e tyre në tregun e punës. Në këtë kuadër, Znj. G. ka përfutuar nga programi i praktikave profesionale, i cili u zbatua pranë Bashkisë Kavajë në periudhën 01.06.2022 — 01.12.2022, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", i ndryshuar. Marrëveshja trepalëshe për këtë praktikë profesionale është protokolluar me Nr. 2734/4, datë 27.05.2022.

Programi i praktikave profesionale synon të lehtësojë tranzicionin e punëkërkuësve të papunë në tregun e punës, duke u mundësuar përfutuesve aftësim në të njëjtën fushë ose në fusha të ngjashme me profilin e tyre profesional. Ky program, i cili ka një kohëzgjatje 6-mujore, zbatohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, sipas të cilave një individ mund të përfitojë vetëm një herë nga i njëjti program brenda një periudhe 5-vjeçare. Pas përfundimit të praktikës profesionale, nuk ekziston asnjë detyrim ligjor për subjektin pjesëmarrës që të punësojë kandidatët.

Pas përfundimit të programit, Zyra e Punës Kavajë ka vijuar t'i ofrojë Znj. G. shërbime të tjera punësimi dhe mundësi alternative, në përputhje me profilin e saj. Megjithatë, Znj. G.,

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1297/4 prot., datë 16.10.2024

ka refuzuar këto oferta, duke shprehur kërkesën për punësim vetëm pranë Bashkisë Kavajë. Aktualisht, sipas të dhënave tona, Znj. G., ka filluar punë në subjektin privat “Indrit Velecja” (supermarket) më datë 16.10.2024, një vend pune që e ka gjetur vetë.

- Me shkresën nr. 1297/5 prot., date 17.10.2024, Komisioneri i ka përcjellë ankueses shkresën nr.5048/1 prot., datë 11.10.2024 të Bashkisë Kavajë dhe shkresën nr.2441/3 prot., datë 27.09.2024 të Agjencisë Kombëtare e Punësimit për të bërë parashtrimet e saja në lidhje me këto përgjigje.
- Me shkresën nr.1297/6 prot., date 24.10.2024, janë administruar pranë Komisionerit kundërshtimet e ankueses, e cila i qëndron të njëjtave pretendime si në ankesë.
- Me shkresën nr.1297/7 prot., date 18.11.2024, Komisioneri i është drejtuar përsëri institucioneve dhe ka përcjellë kundërshtimet e ankueses.
- Me shkresën nr.1297/8 prot., date 21.11.2024, janë administruar pranë Komisionerit kundërshtime shtesë të ankueses.
- Me shkresën nr.2441/4 prot., date 27.11.2024⁴, Agjencia Kombëtare e Punësimit dërgoi informacion dhe shpjegime të mëtejshme në lidhje me këtë çështje, duke sqaruar se: *Znj. S. G., ka qenë e regjistruar si punëkërkuese e papunë në Zyrën Vendore të Punësimit Kavajë, Drejtoria Rajonale e AKPA Tiranë. Znj. G., është trajtuar me programin e nxitjes së punësimit në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", i ndryshuar, pranë Bashkisë Kavajë në periudhën 01.06.2022 - 01.12.2022, sipas Marrëveshjes trepalëshe. Pas përfundimit të programit, Zyra e Punës Kavajë i ka ofruar mundësi të tjera punësimi, por Znj. G., i ka refuzuar ato. Znj. G., është e mirëpritur të paraqitet pranë Zyrës së Punësimit Kavajë për të marrë oferta të tjera punësimi.*
- Bazuar në nenin 33/8 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri, pasi vlerësoi kërkesën e ankueses, caktoi datën 17.12.2024, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr. 1297/9 prot., datë 02.12.2024.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjekti ankues, e përfaqësuar nga Av. I. A, pala kundër të cilës është bërë ankesa Bashkia Kavajë, nuk u paraqitë, ndërkohë janë paraqitur palët e tjera të thirrura në këtë seancë: Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, përfaqësuar nga znj. P. M., sipas Autorizimit nr. 2441/5 prot., datë 16.12.2024 dhe Zyra Vendore Kavajë, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, përfaqësuar nga znj. E. B., sipas Autorizimit nr.3920 prot., datë 16.12.2024.

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1297/10 prot., datë 04.12.2024

⁵ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të regjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në.

- Me shkresën nr. 1297/11, datë 23.12.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar nga Bashkia Kavajë, informacion si më poshtë:
 - Informacion nëse gjatë periudhës kur ankuesja ka vijuar praktikën pranë këtij institucioni ka pasur vend vakant, dhe nëse po, kur është plotësuar ky pozicion pune. *(Informacioni të jetë i shoqëruar me dokumentacionin provues)*
 - Informacion nëse pas mbarimit të periudhës së praktikës janë bërë emërimet të reja dhe, nëse po, cila ka qenë procedura e përzgjedhjes së tyre. *(Informacioni të jetë i shoqëruar me dokumentacionin provues)*
 - Informacion nëse gjatë këtyre periudhave kanë dalë në pension edukatorë, të cilët kanë qenë pjesë e organikës së këtij institucioni.
 - Kopje të organikës së institucionit me emrat përkatës në momentin e ushtrimit të praktikës nga ankuesja pranë këtij institucioni.
 - Kopje të organikës aktuale të institucionit.
 - Qëndrimin zyrtar të Bashkisë Kavajë në lidhje me kërkesën e ankuese për t'u punësuar pranë këtij institucioni.

Nga ana e Bashkisë Kavajë nuk u kthye asnjë përgjigje në lidhje me këtë kërkesë të Komisionerit dhe pse informacioni iu rikërkuar dhe me shkresën nr. 58 prot., datë 09.01.2025.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: “*Organi publik*

siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, *duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës.*

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm të ankueses.

Në nenin 11 të Ligjit nr. 15/2019 *“Për nxitjen e punësimit”*, parashikohet se: Programet e nxitjes së punësimit 1. *Politikat publike të punësimit mbështesin punëkërkuessit, si dhe punëdhënësit, për të krijuar vende të reja pune të qëndrueshme, nëpërmjet programeve të posaçme të nxitjes së punësimit. 2. Programet e nxitjes së punësimit përfshijnë angazhimin e punëkërkuessve të papunë në programe të ndryshme punësimi, punësh publike, vetëpunësimi, praktikash profesionale apo trajnimi, për të cilat parashikohet subvencionim, në përqindje të caktuar, i kostove për: a) sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore; b) pagat; c) formimin profesional; ç) formimin nëpërmjet punës; d) vetëpunësimin; dh) mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit; e) pajisjen e vendit të punës dhe përshtatjen e arsyeshme; ë) zbatimin e programeve për mbështetjen e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë të arsimit dhe formimit profesional; f) punësimin e të diplomuarve/certifikuarve në arsimin e formimin profesional; g) praktikat profesionale; gj) programin e garancisë rinore; h) programet e riintegrit social; i) transport për në vendin e punës; j) ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim; k) të tjera. 3. Programet e nxitjes së punësimit zbatohen dhe administrohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, në bashkëpunim me institucione të tjera publike, përgjegjëse për zhvillimin ekonomik e kualifikimin, si dhe në bashkëpunim me sektorin privat dhe organizata të shoqërisë civile. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mund të kontraktojë subjekte të tjera publike, private apo organizata të shoqërisë civile, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me fushën e punësimit, për të bërë të mundur*

zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit. 4. Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, është miratuar Vendimit i Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, në të cilin është parashikuar se: 1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të mëposhtme të nxitjes së punësimit: a) Programi i punësimit; b) Formimi nëpërmjet punës; c) Praktikat profesionale. 2. Programet, sipas pikës 1 të këtij vendimi, zbatohen në përputhje me nevojat individuale të punëkërkuësit për t’u integruar në tregun e punës dhe në planin individual të integruar për punësimin e tij.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim nga Bashkia Kavajë, për rinovimin e kontratës 1-vjeçare (të praktikave profesionale), referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Znj. S. G., ka mbaruar Arsimin Profesional në profilin “Edukatore për fëmijë 0-3 vjeç”, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, pranë Universitetit të Elbasanit, në periudhën 2019-2022.

Znj. S. G., ka qenë e regjistruar si punëkërkuese e papunë në Zyrën Vendore të Punësimit Kavajë, Drejtoria Rajonale e AKPA Tiranë. Znj. G., është trajtuar me programin e nxitjes së punësimit në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale", i ndryshuar, pranë Bashkisë Kavajë në periudhën 01.06.2022 - 01.12.2022, sipas Marrëveshjes trepalëshe nr.2734/4 prot., datë 27.05.2021.

Referuar informacionit të dërguar nga ana e Bashkisë Kavajë, rezultoi se Znj. S., nuk ka qenë asnjëherë e punësuar nga ana e Bashkisë Kavajë në cilësinë e punëdhënësit, por ajo ka qenë praktikante pranë Çerdhes së Qytetit, në bazë të një marrëveshjeje trepalëshe që ka patur ndërmjet Bashkisë Kavajë për një periudhë gjashtëmujore. Trajtimi financiar është bërë nga fondet e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në përputhje me Marrëveshjen e cila është bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020.

Në këtë moment sqarojmë se ankuesja e pretendon këtë të drejtë në cilësinë e personit me aftësi të kufizuar, por pavarësisht se në pikën 4/c të nenit 3 “Përkufizime” të Ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, është parashikuar: 4. “Grupet e veçanta” janë punëkërkuës të disavantazuar në tregun e punës, si: c) persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse; në rastin konkret, ankuesja nuk është në këto kushte ligjore. Pasi, siç u sqarua dhe nga përfaqësuesja e Agjencisë Kombëtare të Punësimit gjatë seancës dëgjimore të datës 17.12.2024, Marrëveshja trepalëshe nr. 2734/4 prot., datë 27.05.2021, është lidhur për disa praktikante njëkohësisht dhe nuk ka qenë një kontratë e specifikuar

për personat me aftësi të kufizuara, as nuk ka qenë pjesë e ndonjë programi të nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, në Kreun II, pika 3 është parashikuar se: Një punëkërkuar mund të marrë pjesë vetëm një herë në të njëjtin program brenda një periudhe pesëvjeçare.

Referuar Marrëveshjes trepalëshe nr.2734/4 prot., datë 27.05.2021 në pikën 6.2 të saj është parashikuar se: *Kontrata do të ndërpritet automatikisht pasi të plotësohet kohëzgjatja e saj dhe nuk mund të të zgjatet me të njëjtin pjesëmarrës.*

Sa më sipër, në përputhje me legjislacionin dhe provat e paraqitura, Bashkia Kavajë nuk ka detyrimin ligjor për të njoftuar apo rinovuar kontratën 1-vjeçare për praktikant profesional, për sa kohë që as ligji, as vendimi i Këshillit të Ministrave dhe as marrëveshja e aplikuar nuk e kërkojnë këtë veprim.

Së pari, Ligji nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” në nenin 11, parashikon mundësinë e angazhimit të punëkërkuarve në programe të nxitjes së punësimit, përfshirë praktikant profesional, por ai nuk detyron asnjë institucion të vazhdojë apo rinovojë kontratën për periudha të tjera, përveç asaj që është parashikuar në rregullat përkatëse.

Së dyti, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 17, datë 15.01.2020, i cili rregullon procedurat dhe kriteret për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit, sanksionon se një person mund të marrë pjesë vetëm një herë në të njëjtin program brenda një periudhe pesëvjeçare, dhe nuk e parashikon rinovimin e kontratave të praktikantëve për periudha të tjera.

Për më tepër, marrëveshja trepalëshe, e cila rregullon kontratën mes Znj. S., G., dhe Bashkisë Kavajë, në pikën 6.2, specifikon se kontrata ndërpritet automatikisht pas përfundimit të periudhës së parashikuar dhe nuk mund të rinovohet me të njëjtin pjesëmarrës.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Kavajë nuk ka asnjë detyrim ligjor për të rinovuar kontratën e praktikant profesional për Znj. S., G., pasi as legjislacioni në fuqi, as aktet nënligjore të miratuara dhe as marrëveshja përkatëse nuk përfshijnë parashikime që obligojnë rinovimin e kontratës për periudha shtesë pas përfundimit të saj.

Sa më sipër, bazuar në tërësinë e arsyetimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesja S., G., nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Kavajë.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim nga Bashkia Kavajë, për punësim si edukatore pranë çerdhes “Nektari i Jetës”, rezulton se:

Nga ana e ankueses, nuk ka rezultuar që të na jetë vënë në dispozicion asnjë kërkesë e adresuar zyrtarisht pranë Bashkisë Kavajë. Megjithatë, gjatë seancës dëgjimore, ankuesja pranoi se ajo është paraqitur fizikisht pranë Bashkisë Kavajë dhe ka kërkuar emërimin e saj pranë Çerdhes “Nektari i Jetës” në pozicionin që ka pasur gjatë praktikës profesionale që ka kryer pranë kësaj çerdheje. Përfaqësuesja e Zyrës Vendore Kavajë, në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, gjatë seancës dëgjimore tregoi se ankueses i janë afruar disa pozicione të tjera pune në sektorin privat, por ajo nuk i ka pranuar, pasi qëllimi dhe dëshira e saj është të punojë pranë çerdhes, e cila i përshtatet edhe profilit të saj arsimor. Ankuesja aktualisht është e punësuar pranë një biznesi privat.

Ndërkohë, referuar përgjigjes së kthyer nga Bashkia Kavajë, është pranuar fakti që ankuesja ka kërkuar punësim pranë kësaj çerdheje, por sistemimi i ankueses në pozicionin “Kujdestare Çerdhje” pranë institucionit të Bashkisë Kavajë nuk ka qenë i mundur, për arsye se nuk ka pasur dhe nuk ka vende të lira pune. Ankueses i është bërë e qartë se në momentin e parë që do të hapet një pozicion vakant, ajo do të ketë përparësi para konkurrentëve të tjerë. Për sa i përket pozicionit “Kujdestare Çerdhje”, nuk janë hapur pozicione të reja pune dhe për rrjedhojë nuk janë lidhur kontrata.

Referuar nenit 60, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është parashikuar se: “1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit...”.

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është miratuar Udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

Në Kreu 12, pika 2 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Për mësuesit e institucioneve parashkollore, njësitë e vetqeverisjes vendore, kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

Në Kreu 8, pika 4 të Udhëzimit nr. 12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, është parashikuar se: Kandidati që në renditjen e përgjithshme ka numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e përzgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve, përmes adresës elektronike. Nëse kandidatët rezultojnë me pikë të përbashkët, përparësi ka kandidati që mund të jetë

me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka kandidat me aftësi të kufizuar, vendi i lirë i punës i afrohet kandidatit që ka rezultatet më të larta në testim.

Përsa më sipër, pas shqyrtimit të informacionit të vënë në dispozicion gjatë hetimit administrativ, ankuesja nuk rezulton të jetë regjistruar në këtë portal, dhe për pasojë, nuk mund t'i mundësohej emërimi pranë këtij institucioni në rast të një vakance, sipas procedurave të parashikuara ligjore.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”.

Në nenin 12/1/c) të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Për sa më sipër, bazuar në faktet dhe rrethanat e paraqitura, rezulton se Bashkia Kavajë nuk ka ushtruar asnjë veprim të padrejtë ndaj ankueses, S., G. Pavarësisht se ajo ka kërkuar punësim pranë Çerdhes “Nektari i Jetës”, nuk ka pasur mundësi për emërimin e saj për shkak të mungesës së vendeve të lira. Për më tepër, ankueses i është shpjeguar se në rast se do të hapet një pozicion vakant, ajo do të ketë përparësi në procesin e rekrutimit. Sipas procedurave ligjore të përcaktuara, ajo nuk është regjistruar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, i cili është i nevojshëm për të qenë i mundshëm aplikimi për një pozicion të tillë. Për këtë arsye, nuk ka asnjë indikacion që Bashkia Kavajë ka vepruar në mënyrë të padrejtë ndaj saj.

Në referencë, të nenit 7/1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, ankuesja S., G., nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Kavajë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses znj. S., G, në të drejtën për punësim, nga ana e

- Bashkisë Kavajë, për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA